



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 81-të të mbajtur më 03.02.2023 ka miratuar si në vijim.

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-1320/1 të datës 09.02.2021, me pretendime për t; paligjshme të ///, HIDHET POSHTË .

KSHPK-ja konstatoi se sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk ka elemente për veprim kompetent.

Lënda me numër 12-1320/1 të datës 25.03.2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimarrjes.

Arsyetim

Me datë 25.03.2021, është dorëzuar denoncim me pretendime për veprime të kundërligjshme të /// dhe është formuar lënda me numër 12-1320/1 të datës 25.03.2021.

Në denoncim, parashtruesi i kërkesës thekson se në vitin 2012, në bazë të vendimit të /// ///, ka fituar të drejtën e pensionit të pleqërisë në shumë prej /// denarë, që është shuma më e lartë se shuma më e lartë e përcaktuar me ligj. Në vendim thuhej se nëse pensioni i përcaktuar është mbi pensionin më të lartë, do të paguhet pensioni më i lartë, ndërsa rregullimi aktual mujor i pensionit në vitet aktuale dhe të ardhshme do të bëhet nga Fondi sipas detyrës zyrtare. Fondi nuk ka vepruar sipas dispozitave të përcaktuara në këtë mënyrë, gjegjësisht nuk ka kryer rregullime mujore aktuale të pensionit, gjë që sipas pretendimeve të parashtruesit i ka mohuar të drejtat pensionistëve. Ai kërkon nga KSHPK-ja që të ndër marrë veprime brenda kompetencës së saj.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja konstaton se denoncimi ka të bëjë me pretendime që nuk janë objekt i veprimit kompetent të KSHPK-së, por bëhet fjalë për pretendime

që kanë të bëjnë me veprimin kompetent të një organi tjetër kompetent, në rastin konkret të /// e cila në pajtim me nenin 186 paragrafi 1 të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 98/2012, 166/2012, 15/2013, 170/2013, 43/2014, 44/2014, 97/ 2014, 113/2014, 160/2014, 188/2014, 20/2015, 61/2015, 97/2015, 129/2015, 129/2015, 129/2015, 2015 2015, 217/2015, 27/2016, 120/2016, 132/2016, 35/2018, 220/2018 dhe 245/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 129/19,275 31/2020, 267/2020 dhe 67/2022), mbikëqyr funksionimin dhe ligjshmërinë e punës së Fondit për sigurim pensional dhe invalidor të Maqedonisë.

Nga këtu KSHPK-ja vlerësoi se nuk ka kompetencë për veprim në rastin e lëndës.

Në bazë të së theksuarës, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Dorëzuar deri te:

- parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: B.M.

Miratoi: G.T, anëtar i KSHPK-së

**KOMISIONI SHТETЁRORE ПЁR
PARANDALIMIN KORRUPTIONIT
KRYETARE,
Biljana Ivanovska**